

Pagesa e Papunësisë në mbështetje të tregut të punës

Programi i pagesës së papunësisë janë pjesë e politikave shtetërore të punësimit të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.

Programet e Pagesës së Papunësisë synojnë të mbështesin financiarisht të gjithë punëkërkesit e papunë në rast papunësie për shkak të shkurtimit të vëndit të punës, ndërprejes së kontratës së punës, falimentimit të ndërmarrjes, zvogëlimit të aktivitetit etj, duke lehtësuar sadopak përpjekjet e tyre drejt punësimit.

BAZA LIGJORE E PROGRAMIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË

1. VKM Nr. 161, datë 21.03.2018 “Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia”;
2. Udhëzim Nr. 17, datë 14.05.2018 Mbi zbatimin e VKM-së Nr. 161, datë 21.03.2018, “Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia”;
3. Marrëveshje “Për kryerjen e pagesave të papunësisë”, midis SHKP-it dhe CREDINS Bank.

KUSH JANË KUSHTET E PËRFITIMIT.

Përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të kenë kontribuar në sigurimin shoqëror për një periudhë të paktën 12 mujore gjithsej, (për çdo rast përfitimi).
- b) Të jenë regjistruar si punëkërkes të papunë pranë zyrës përkatëse të punësimit.
- c) Të kenë paraqitur kërkesën me shkrim për aplikim dhe të kenë plotësuar dokumentacionin përkatës, brenda 60 ditëve nga data e shpërndarjes së marrëdhënieve financiare me punëdhënësin. Jashtë këtij afati përfituesit e humbasin të drejtën e pagesës së të ardhurës nga papunësia, me

përrjashtim të rasteve kur janë të paaftë për punë, e vërtetuar kjo me raport mjekësor ose dokumente shoqëruese, që kanë qenë të shtruar në spital (fletë hyrje dhe fletë dalje nga spitali)

CILI DO TË JETË NIVELI BAZË I PËRFITIMIT ?

Çdo përfitues i pagesës papunësie merr një nivel bazë, i cili është sa 50% e pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Niveli bazë është barabartë për të gjithë përfituesit, pavarësisht nga paga që është paguar në punë. Aktualisht, niveli bazë i pagesës së papunësisë është 15.000 lekë në muaj (50% e pagës minimale në shkallë vendi). Çdo përfitues do të përfitojë bashkë me pagesën e papunësisë dhe **shtesën familjare prej 5%** mbi nivelin bazë, për fëmijët deri në moshën 18 vjeç që janë të përfshirë në sistemin arsimor dhe ata që studiojnë apo janë të paaftë për punë (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç;

SA KOHË ZGJAT PAGESA E PAPUNËSISË ?

Çdo përfituesi i paguhet e ardhura e papunësisë në varësi të periudhës së kontributit në sigurimet shoqërore derdhur nga punëdhënësi si më poshte:

- a) 3 muaj përfitim, nëse kanë të paktën 12 muaj gjithsej kontribute të sigurimeve shoqërore (duke filluar nga përfitimi i fundit).
- b) 6 muaj përfitim, nëse kanë të paktën 3 vjet gjithsej kontribute të sigurimeve shoqërore (duke filluar nga përfitimi i fundit).
- c) 9 muaj përfitim, nëse kanë të paktën 5 vjet gjithsej kontribute të sigurimeve shoqërore (duke filluar nga përfitimi i fundit).
- d) 12 muaj përfitim, nëse kanë mbi 10 vjet gjithsej kontribute të sigurimeve shoqërore (duke filluar nga përfitimi i fundit).
- e) Personat gra mbi 55 (pesëdhjetë e pesë) vjeç dhe burra mbi 60 (gjashtëdhjetë) vjeç përfitojnë pagesë papunësie 12 (dymbëdhjetë) muaj, me kusht që të kenë kontribuar 1 (një) vit në sigurimet shoqërore për çdo rast përfitimi.

Për çdo rast përfitimi personi duhet të ketë të paktën 12 muaj gjithsej kontribute të derdhura në sigurimet shoqërore.

Në rastet e punësimit gjatë periudhës së përfitimit të pagesës së të ardhurës nga papunësia apo gjatë periudhës së kualifikimit/rikualifikimit (me pagesë), e ardhura e papunësisë merret me ndërprerje për një periudhë:

- a) brenda 6 muajve, për personat që përfitojnë 3 muaj pagesën e të ardhurës nga papunësia,
- b) brenda 12 muajve, për personat që përfitojnë 6 muaj pagesën e të ardhurës nga papunësia,

- c) brenda 18 muajve, për personat që përfitojnë 9 muaj pagesën e të ardhurës nga papunësia,
- d) brenda 24 muajve, për personat që përfitojnë 12 muaj pagesën e të ardhurës nga papunësia.

Për hollësi kontaktoni specialistët e Zyrës së Punësimit në rrethin tuaj.

ÇFARË DOKUMENTESH DUHEN PËR TË PËRFITUAR TË ARDHURËN NGA PAPANËSIA ?

Personat, të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

Dokumenta që do paraqesë vetë personi përfitues: a)

Librezë pune;

b) Kartë e identitetit (fotokopje);

c) Vërtetim për ndjekjen e shkollës, për fëmijët deri në moshën 18 vjeç që janë të përfshirë në sistemin arsimor dhe ata që studiojnë apo janë të paaftë për punë (KMCAP) që kanë mbushur moshën 25 vjeç; (ky vërtetim nuk është i përfshirë në listën e dokumentave on-line)

Të gjithë dokumentat e mëposhtme do të nxirren on-line nga specialisti i zyrës së punësimit. c)

Certifikatë e gjendjes familjare;

d) Vërtetim nga dega e tatim-taksave, se personi nuk është subjekt i regjistruar pranë këtyre organeve;

e) Vërtetim nga dega e tatim taksave ose e sigurimeve shoqërore se personi ka derdhur kontribute për periudhën e kërkuar sipas shkronjave (a),(b),(c), dhe (ç), të pikës 4, të VKM-së.

Personat duhet të njoftojnë brenda 5 (pesë) ditëve, zyrën përkatëse të punësimit, nëse gjatë periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia.

a) punësohen ose vetëpunësohen

b) ka ndryshime në gjendjen familjare (lindje apo vdekje)

c) personat, që janë në ngarkim të tij, kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe ata që studiojnë apo janë të paaftë (KMCAP), kanë mbushur moshën 25 vjeç (të shoqëruar me vërtetimet përkatëse)

KUSH NUK E PËRFITON TË ARDHURËN NGA PAPANËSIA

Personat nuk përfitojnë të ardhurën nga papunësia kur:

- a) ndërpresin aktivitetin si punëdhënes dhe të vetëpunësuar

- b) largohen nga puna me dëshirën e tyre (konventa nr. 168 e ILO-s).
- c) plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar, paaftësi e përkohshme në punë apo sëmundje profesionale.
- d) janë duke vuajtur dënimin me heqje lirie.
- e) janë larguar jashtë shtetit për arsye të ndryshme.

RASTET E PËRLIGJURA, KUR PËRFITUESI ËSHTË I JUSTIFIKUAR PËR MOSPARAQITJE,

Rastet e perligjura për mosparaqitje janë:

- a) sëmundje e vërtetuar me dokumente (fletë shtrimi në spital).
- b) vdekja e një pjesëtari të familjes, e vërtetuar me certifikatë vdekje.
- c) ndalim nga organet e drejtësisë.

Niveli bazë i së ardhurës mujore nga papunësia është e njëjtë për çdo përfitues.